

Emri i Lëndës : Krimi Financiar dhe Kibernetik							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 435	B	Vjeshtë	4.00	0.00	0.00	4.00	6.00
Lektori		Yasin Sezer, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Lënda Krimi Financiar dhe Kibernetik studion drejtimet kryesore të zhvillimit të krimit financiar në vendin tonë si dhe zhvillon më tej njohuritë e studentëve në lidhje me problematikat bashkëkohore të aplikimit të përgjegjësisë penale ndaj formave të krimit kibernetik. Kjo lëndë do të trajtojë çështjet ligjore që ngrihen për diskutim në praktikën e organeve të drejtësisë penale dhe punonjësve të agjensive ligjzbatuese gjatë përballjes së tyre me forma të ndryshme të krimit financiar apo kibernetik. Vëmendje e veçantë i është kushtuar paraqitjes së teknikave specifike për identifikimin dhe hetimin e krimit kompjuterik. Transmetimi i dijeve bëhet në mënyrë graduale nëpërmjet shpjegimit të koncepteve thelbësore, përcjelljes së njohurive teorike dhe referimit në dispozitat ligjore të zbatueshme ndaj veprimeve kriminale në fjalë.					
Objektivat		Lënda synon që studentët të identifikojnë dhe shpjegojnë saktë ligjin e pastrimit të parave. Të kuptojnë se si ndikojnë krimet financiare në punën dhe përgjegjësitë e individëve. Qëllimi i kësaj lënde është të zhvillojë metodologji në analizimin dhe dokumentimin e krimeve kibernetike. Lënda ofron mbulim edhe të tematikave të tilla siç janë shkelja e pronësisë intelektuale, rreziqet e sigurisë , krimin në internet , vjedhjet e identitetit, survejimi i punonjësve, privatësinë dhe pajtimin. Gjatë analizimit të këtyre temave studenti do të fitojë aftësi vendim marrjeje për menaxherët e bizneseve dhe profesionistëve.					
Konceptet Kryesore							
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Çfarë është krimi financiar. Përgjegjësia penale e personit juridik						
2	Pastrimi produkteve të veprës penale (pastrimi i parave)						
3	Korrupsioni dhe ushtrimi i ndikimit të paligjshëm						
4	Krimet në fushën e doganave						
5	Shpërdorimi i detyrës. Krimet në fushën e tatimeve dhe taksave						
6	Mashtrimi në subvencione, në sigurime, në kredi etj.						
7	Krimi kibernetik. Mashtrimi kompjuterik						
8	Provim Gjysmëfinal						
9	Veprat penale kundër integritetit dhe fshehtësisë të të dhënave dhe sistemeve kompjuterike						
10	Hyrja e paautorizuar kompjuterike dhe keqpërdorimi i paisjeve të aksesit në një sistem kompjuterik.						
11	Sulmet kundër integritetit të sistemeve kompjuterike dhe disponueshmërisë së shërbimeve të shoqërisë së informacionit						
12	Përgjimi i paligjshëm i komunikimeve elektronike						

13	Impersonifikimi online dhe përgjegjësia penale
14	Infrastruktura dhe politikat e sigurisë së informacionit. Menaxhimi i rrezikut
15	Përgjegjësia e ofruesve dhe operatorëve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike. Aspekte ndërkombëtare dhe juridiksioni
16	Provim Final
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura • Evisa Kambellari, "Cikël leksionesh mbi krimin financiar dhe kibernetik" (Tiranë 2014) • Jonathan Clough, "Principles of Cyber-crime" (Cambridge: Cambridge University Press 2010) • "Udhëzues për hetimin e korrupsionit dhe krimit financiar" (Tiranë: Botimet Dudaj 2010) • Ligji nr.7895, dt. 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. • Ligji Nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" • Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
Referenca të tjera • Howard E Williams, "Investigating White-collar Crime: Embezzlement and Financial Fraud" (2nd edition, Illinois: Charles C Thomas Publisher 2006) • Iljasa Salihu, "Krimi ekonomik, sfidat e sigurisë kombëtare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, përballë krimit ekonomik" (Shkup: Print Ism 2012) • "Biznesi, korrupsioni dhe krimi në Shqipëri: Ndikimi i rryshfetit dhe krimeve të tjera në ndërmarrjet private" (Vjenë: UNODC 2013)	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studenti do të jetë në gjendje të kuptojë dhe shpjegojë drejtimit e ndryshme të krimit financiar.
2	Të përvetësojë njohuri të qarta mbi teknikat e konsumimit të krimeve financiare.
3	Të zbatojë drejtë elementët e reagimit ligjor ndaj formave të aktivitetit kriminal me natyrë ekonomike.
4	Studenti do të jetë në gjendje të identifikojë një aktivitet kriminal që kryhet në mjedisin virtual.
5	Studenti do të mund të kuptojë drejtimit e reja të shfaqjes së krimit kibernetik.
6	Kuptojë se si programet apo paisjet e dëmshme përdoren nga ana e keqbërësve për realizimin e qëllimeve të tyre kriminale.
7	Të ndërtojë një projektim të qartë të infrastrukturës dhe politikave të nevojshme për sigurinë e informacionit në fushën e komunikimeve elektronike

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	1	10	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	1	10	10
Gjysmë finale	1	13	13
Provimi final	1	20	20
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			149
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.96
ECTS			6.00